



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN

---

Numri i lëndës: 2020:015881  
Datë: 16.10.2020  
Numri i dokumentit: 01196836  
C.nr.140/20

**GJYKATA THEMELORE NË GJILAN**, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil me përmes gjyqtarit Blerim Beshitca, në çështjen kontestimore të paditëses M.. O...nga Gj..., të cilën me autorizim e përfaqëson F. S..., avokat në Gj kundër të paditurës, K e Gj - ., të cilën e përfaqëson përfaqësuesi ligjor i saj, A. M. nga Gj, me objekt kontesti, kompensim i shpërblimit jubilar, vlera e kontestit ..€, pas mbajtjes së shqyrtimit kryesor dhe publik, më datë 16.10.2020, mori këtë:

**AKTGJYKIM**

I. APROVOHET në tërësi si e bazuar kërkesëpadia e paditëses M. O nga Gj. dhe detyrohet e paditura K. e Gj.-Q K e M... F.... në Gj, që paditëses t'ia paguajë shumën në lartësi prej ....€, në emër të kompensimit të shpërblimit jubilar për 22 vite e tetë muaj përvojë pune, me kamatë ligjore prej 8 %, duke filluar nga data ....e deri në pagesën përfundimtare, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm

II. DETYROHET e paditura që paditësit t'ia paguaj shpenzimet e procedurës gjyqësore në shumë prej .... €, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh, pas ditës së pranimit të këtij Aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm.

**A r s y e t i m i**

Paditësja..., përmes të autorizuarit të saj, F..S, avokat në Gj, në këtë gjykatë më datë..., fillimisht ka paraqitur padi kundër të paditurës për shpërblimin jubilar dhe kompensimin me rastin e pensionimit, ndërsa në shqyrtimin gjyqësor të mbajtur më datën ....e ka precizuar padinë duke e zvogëluar kërkesëpadinë, ashtu që tani e tutje ka kërkuar nga gjykata që ta obligojë të paditurën që paditëses t'ia paguaj shpërblimin jubilar në vlerë të 2 (dy) pagave mujore, konkretisht shumën prej ..€, ndërsa sa i përket pagave përcjellëse e ka tërhequr këtë kërkesë pasi që të njejtën e paditura ia kishte kompensuar. Paditësja në padi ka theksuar se ka qenë në mardhënie pune te e paditura e përcaktuar në vendin e punës Pastruese në shërbimin teknik deri më datën ... ku sipas fuqisë ligjore i është ndërprerë marrëdhënia e punës për shkak të arritjes së moshës së pensionimit. Pas marrjes së vendimit për pensionim, paditësja i është drejtuar të paditurës si ish punëdhënëse me kërkesë verbale që t'ia paguaj 3 (tri) paga jubilarë të punës mbi 30 vite dhe kompensimin e pagave përcjellëse në vlerë të 3 (tri) pagave që i ka marr 3 (tre) muajt e fundit, kërkesa këto të parapara në nenin 17 të Kontratës Kolektivë Sektoriale të

Shëndetësisë, por që deri më tani e paditura nuk i ka paguar asnjë pagë, me gjerësisht si në këtë padi.

Gjykata në këtë çështje juridike kontestimore pas shqyrtimit paraprak të padisë me datë ....ka nxjerrë aktvendimin për përgjigje në padi, të cilën e paditura e ka pranuar me datë..... Me aktvendimin për përgjigje në padi, gjykata e ka njoftuar të paditurën për detyrimin ligjor për dhënie të përgjigjes në padi dhe për pasojat ligjore që do të ketë nëse nuk paraqet përgjigje në padi.

E paditura në përgjigje në padi e ka kundërshtuar në tërësi kërkesëpadinë e paditëses duke i propozuar gjykatës që të vepron sipas nenit 68 lidhur me nenin 67 të Ligjit për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr.03/L-48 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësit dhe ta pezullojë rastin në afat prej 180 ditësh si dhe ta njoftoj Ministrinë e Drejtësisë mbi rastin dhe ti siguroj Ministrisë së Drejtësisë një kopje të plotë të lëndës. Po ashtu ka shtuar se e kundërshton padinë dhe kërkesëpadinë e paditëses në mungesë të provave, e më gjerësisht si në përgjigjen në padi.

Përfaqësuesi i paditëses, si në shqyrtimin përgatitor, kryesor ashtu edhe në shpjegimet përfundimtare ka deklaruar se mbetet në tërësi pranë padisë dhe kërkesëpadisë së paditëses, duke theksuar se pas pranimit të provave nga e paditura, siç është librezja e punës e M.O, vërtetohet se e njejta ka .....përvojë pune. Po ashtu pas pranimit të listës së pagave me të cilat e paditura pretendon se ia ka paguar pagat përcjellëse paditëses e ka zvogëluar kërkesëpadinë, ashtu që ka kërkuar nga gjykata që ta obligojnë të paditurën që paditëses t'ia paguaj shpërblimin jubilar në vlerë të 2 (dy) pagave mujore, konkretisht shumën prej ..., ndërsa ka hequr dorë sa i përket 2 (dy) pagave përcjellëse. Po ashtu ka shtuar se sa i përket pretendimeve të të paditurës se paditësja nuk i ka shfrytëzuar mjetet administrative të parapara në nenin 78 dhe 79 të Ligjit të Punës (LP), i njejti e ka theksuar se kërkesa e tyre ka të bëjë me para, e që e kanë përdorur nenin 87 të LP-së, ndërsa nenet tjera kanë të bëjnë me konteste të tjera siç janë ndërrimi i vendit të punës apo ulja në pozitë apo të tjera e jo të natyrave kur kërkesa janë në para. Në fund ka kërkuar nga gjykata që pas adminsitrimin të provave ta aprovoj kërkesëpadinë e paditëses si të bazuar në legjislacionin në fuqi duke e detyruar të paditurën që paditëses t'ia paguaj shpërblimin jubilar në lartësi prej ....cent, me kamatë ligjore prej 8%, duke filluar nga dita e paraqitjes së padisë e deri në pagesën përfundimtare. Gjithashtu i njejti i ka kërkuar edhe shpenzimet e procedurës duke i specifikuar të njejtat.

Përfaqësuesi ligjor i të paditurës, në shqyrtimin përgatitor, kryesorë ashtu edhe në shpjegimet përfundimtare ka deklaruar se mbetet në tërësi pranë përgjigjes në padi, duke e kundërshtuar vetëm bazën juridike të kërkesëpadisë, me arsyetimin se e paditura nuk është nënshkruese e kësaj kontrate, dhe në bazë të LVL-së K... del autoritet i veçantë të cilat e kanë buxhetin e veçantë, si dhe menaxhojnë në mënyrë të pavarur nga ndonjë ndërhyrje apo institucion tjetër. Po ashtu ka shtuar se paditësja nuk ka ndërmarrë asnjë verpim procedural, administrativ, me qëllim të realizimit të kërkesës së saj por direkt i është drejtuar gjykatës për realizimin e kësaj kërkesë. Si arsye tjetër ka theksuar se sipas LP-së, i cili rregullon këtë kategori të punonjësve publik ka paraparë afatin prej 30 ditëve për ndërmarrjen e veprimeve administrative e gjyqësore në lidhje me realizimin e kërkesave eventuale, e që në rastin konkret nuk kemi asnjë

veprim konform dispozitave të këtij ligji. Në fund ka kërkuar nga gjykata që kërkesëpadia e paditëses sa i përket shpërblimit jubilar të refuzohet si e pabazuar.

Gjykata për të vepruar drejtë dhe për ti vërtetuar pretendimet e palëve ndërgjyqëse, si dhe për ta vërtetuar drejtë gjendjen faktike në këtë çështje kontestimore, ka administruar dhe vlerësuar këto prova materiale: Kontratën për kohë të pacaktuar, nr.....; Vendimin për ndërperjen e marrëdhënies së punës, nr....., të dt....; Vendimin për kompensimin e 3 (tri) pagave, nr....., të dt....; Monitorimin e transkasionit të pagesave, të lëshuar nga TEB për periudhën nga dt.... e deri më datën....; Listën e pagave me të cilën kofirmohet se paditësja i ka marrë 3 (tri) paga në shumë prej .....€ dhe Kopjen e librezës së punës ku vërtetohet përvoja e punës së paditëses në QKMF.

Pas vlerësimit me kujdes të secilës provë veç e veç dhe të gjithave së bashku si në kuptim të nenit 8 të LPK-së si dhe në bazë të rezultatit të gjithmbarshëm të procedurës kontestimore, gjykata vërtetoi faktin se paditësja M.O... ka qenë në marrëdhënie pune në Q... K...të M... F... në Gj...në vendin e punës që nga data ....e deri më datën...., ku pas plotësimit të mbushjes së moshës së pensionimit, me dt..... i ndërprehet marrëdhënia e punës sipas fuqisë ligjore nga, fakt ky i cili vërtetohet nga vendimi për ndërprejen e marrëdhënies, nr.....

Nga Kontrata për kohë të pacaktuar, nr....., gjykata vërtetoi faktin se paditësja ka qenë e punësuar te e paditura, përkatësisht ), dhe e njehta ka qenë e sistemuar në punë dhe detyra punuese në dhe në lokacionet tjera të Q...K...M...F...-së, edhe ate në kohë të pacaktuar duke filluar nga data e tutje.

Nga Vendimi për kompensimin e 3 (tri) pagave, nr....., gjykata vërtetoi faktin se paditëses M... O...e caktuar në punë dhe detyra punuese pastruese në shërbimin teknik i është lejuar kompensimi (pagesa) përcjellëse në lartësi prej tre (3) pagave me rastin e pensionimit konform nenit 17 paragrafi 5 të Kontratës Kolektive Sektoriale të Ministrisë së Shëndetësisë lidhur me Federatën e Sindikatave të Shëndetësisë së Kosovës.

Nga Monitorimi i transkasionit të pagesave, të lëshuar nga Tnë Gj, gjykata vërtetoi faktin se ky monitorim është bërë për periudhën nga dt.... e deri më datën ....në llogari të M. O, dhe paditësja në 3 (tre) muajt e fundit ka realizuar pagë mujore nga ...€.

Nga Lista e pagave, gjykata vërtetoi faktin se paditësja në 3 (tre) muajt e fundit ka marrë 3 (tri) paga në shumë prej .....€.

Nga Kopja e librezës së punës në emër të paditëses, gjykata vërtetoi faktin se e njehta ka përvojë pune në.....

Gjykata në këtë çështje kontestimore sa i përket të drejtës subjektive të paditëses, bazës juridike të padisë dhe lartësisë së saj, ka zbatuar dispozitat e Kontratës Kolektive Sektoriale të Shëndetësisë, konkretisht nenin 4 paragrafi 3, e cila ka hyrë në fuqi nga dt.11.06.2018, në të cilën dispozitë është përcaktuar se: “ *Përfitues të beneficioneve të cilat dalin nga kjo marrëveshje dhe të cilat bazohen në Ligjin e Punës janë të gjithë punëtorët shëndetësor, ndërsa beneficione /dobitë/ që dalin nga marrëveshjet e që nuk janë pjesë e Ligjit të Punës i gëzojnë*

vetëm anëtarët FSSH-ës, si dhe nenin 17 paragrafi 3, pika 3.2 dhe par.4 të po kësaj Kontrate Sektoriale ku potencohet se: *“Punëtorët shëndetësorë, në vitet jubilarë të punësimit përfitojnë shpërblimin jubilar nga punëdhënësi i fundit në vlerë për 20 vjet të përvojës në punë në institucione shëndetësore në vlerë të dy pagave mujore të tij. Punëdhënësi i fundit është që paguan shpërblimin jubilar. Shpërblimi jubilar paguhet në afat prej një muaji, pas plotësimit të kushteve nga ky paragraf”*. Në rastin konkret rezulton se paditësja ka përvojë pune mbi ... vite, fakt ky i cili nuk ka qenë kontestues ndërmjet palëve ndërgjyqëse, por edhe i vërtetuar me provat e cekura më lartë, andaj në bazë të cekurave më lartë dhe dispozitave të lartëcekura, paditësja ka të drejtë në kompensim të shpërblimit jubilar në vlerë të 2 (dy) pagave mujore në lartësi prej ...€.

Lidhur me pretendimet e të paditurës se në rastin kemi parashkrim të kërkesës, gjykata një pretendim të tillë e refuzoi me arsyetimin se paditësja ka arritur moshën e pensionimit sipas fuqisë ligjore me datë...., ndërsa padinë në gjykatë e ka paraqitur me datën ....çka do të thotë se në afatin e paraparë ligjor konform dispozitave të nenit 87 i Ligjit të Punës, i cili në mënyrë shprehimore ka paraparë se: *“Të gjitha kërkesat nga marrëdhënia e punës në para parashkruhen brenda afatit prej tri vitesh nga dita e paraqitjes së kërkesës”*, çka nënkupton se kërkesa e paditëses nuk është përfshirë në parashkrim.

Gjykata ka vendosur si në pikën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi që ta detyrojë të paditurën që paditësit t’ia paguaj shpenzimet e procedurës gjyqësore në lartësi prej ... € edhe atë për pagimin e taksës për paraqitjen e padisë shumë prej ...€, për përpilimin e padisë në shumë prej ... € dhe për përfaqësim të një séance në shumë prej ... €, duke u bazuar në nenin 463.1 të LPK-së.

Andaj nga arsyet e cekura më lartë, dhe duke u bazuar në nenin 143 të LPK-ës, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË GJILAN**  
**C.nr. 140/20, dt.06.10.2020**

**Gjyqtari,**  
**Blerim BESHTICA**

**UDHËZIM JURIDIK:** Kundër këtij aktgjykimi, është e lejuar ankesa Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë, në afat prej 7 ditë, pas ditës së pranimit të vendimit. Ankesa dorëzohet në kopje të mjaftueshme përmes kësaj gjykate.